



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA  
SHKODËR  
Nr. 9384 Prot  
Shkodër, më 31.05.2019



SHOQATA E MOTORISTËVE  
"SHQIPONJAT E RRUGËVE  
SHQIPËRI"  
Nr. 12 Prot  
Shkodër, më 3.6.2019

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot me datë \_\_\_/05/2019 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi mes palëve:

**Bashkia Shkodër** me seli ligjore në rrugën "13 Dhjetori", Shkodër, përfaqësuar nga zj. Voltana Ademi në cilësinë e titullarit të institucionit,

dhe

**Shoqata E MOTORISTËVE "SHQIPONJAT E RRUGËVE SHQIPËRI"**, me seli në Rrugën "Mine Peza", nr 126, Tiranë, regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr 895/1, dt. 16/01/2014, përfaqësuar nga Z. Etrit Beci, në cilësinë e anëtarit të Bordit Drejtues të Shoqatës.

#### Baza ligjore:

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Ligji nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

VKB nr. 1, datë 22.1.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i ndryshuar, pjesa II, pika 4.10.

#### Objekti:

Bashkëpunimin me qëllim zhvillimin e aktivitetit ndërkombëtar promocional "Festa e Motoristëve".

#### Qëllimi:

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



Organizimin e përbashkët të aktivitetit "Festa e Motoristëve" që do të synojë gjallërimin e jetës social kulturore në territorin e Bashkisë Shkodër, promovimin e vlerave të vecanta të pasurive natyrore dhe të trashëgimisë kulturore të Shkodrës.

Përfshirjen nga tarifa e përkohshme të Shoqatës së MOTORISTËVE "SHQIPONJAT E RRUGËVE SHQIPËRI" për aktivitetin e organizuar në partneritet me Bashkinë Shkodër për promovimin e produktit territorial.

#### **Duke qenë se:**

Bashkia Shkodër ka prioritet zhvillimin dhe promovimin e territorit nëpërmjet

- Zhvillimit, mbrojtjes dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore
- Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar lokal;
- Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor.

**Shoqata E MOTORISTËVE "SHQIPONJAT E RRUGËVE SHQIPËRI"** është e përbërë nga dashamirës të shëtitjes me motorë të karakterizuar nga dashuria për Shqipërinë dhe bukurinë e saj dhe që organizojnë aktivitete në qytete të ndryshme të Shqipërisë pikërisht për promovimin e vlerave të monumenteve të natyrës dhe të trashëgimisë kulturore. Pikërisht për këtë qëllim do të shërbejë edhe aktiviteti i kësaj shoqate, që organizohet me datën 22-23/06/2018 në qytetin e Shkodrës sipas kërkesës që ka paraqitur kjo shoqatë me datë 02/05/2018, prot. 12.

#### **Neni 1 Forma e bashkëpunimit**

Për sa më sipër, palët bien dakort,

**Shoqata E MOTORISTËVE "SHQIPONJAT E RRUGËVE SHQIPËRI"** angazhohet në:

1. Merr përsipër organizimin e aktivitetit në respekt të kuadrit ligjor për aktivitete të këtij lloji.
2. Shoqata do të zhvillojë aktivitetin sipas programit të paraqitur në kërkesën e saj me datë 8/02/2019.
3. Gjatë zhvillimit të aktivitetit Shoqata është përgjegjëse për mosdëmtimin e pasurisë publike dhe çdo dëmtim i saj do pasohet me penaltete sipas kuadrit ligjor.
4. Në fund të aktivitetit, Shoqata do të duhet të dorëzojë sheshin në të njëjtat kushte në të cilat e ka marrë në përdorim, përfshirë edhe pastrimin e mjediseve publike.

**Bashkia Shkodër** angazhohet në:

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkodere.gov.al](http://www.bashkiashkodere.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkodere.gov.al](mailto:info@bashkiashkodere.gov.al)



1. Vënie në dispozicion të aktivitetit të Sheshit përpara Bashkisë sipas planimetrisë e cila i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje.
2. Vënie në dispozicion të Policisë Bashkiake me qëllim mbarëvajtjen e aktivitetit.
3. Ofrimin e një linje të energjisë elektrike në funksion të aktivitetit.
4. Caktimin e një koordinatori nga stafi i Bashkisë për koordinimin mes Bashkisë dhe Shoqatës.

## **Neni 2** **Afati i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet nga palët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, me afat nga momenti i nënshkrimit të saj deri me datë 08.06.2019.

## **Neni 3** **Komunikimi**

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

## **Neni 4** **Njoftimet**

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi mes palëve do të bëhet sipas mënyrës së parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi, njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të marrëveshjes.

## **Neni 5** **Zgjidhja e marrëveshjes**

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 7 ditë përpara.

Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontradite do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshje ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 6** **Dispozitat e fundit**

---

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Kjo marrëveshje u hartuar në tre kopje, nga të cilat njërën e merr shoqata ndërsa dy Bashkia Shkodër.

PËR  
BASHKINË SHKODËR

KRYETAR

  
Voltana Ademi



PËR  
Shoqatën E MOTORISTËVE  
"SHQIPONJAT E RRUGËVE  
SHQIPËRI"

Anëtar i Bordit Drejtues

Etrit Beci



*Koncepti  
geohistorik  
V. Ademi*

# Rruga Kolë Idromeno - Zona e lejuar për zhvillimin e aktivitetit

